



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian

Java e
Shoqërisë
Civile
2023

PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

QENDRA KOMBËTARE BURIMORE
PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI

SCiDEV
SCIENCE & INNOVATION FOR DEVELOPMENT

FORUMI RINOR I DEBATUESVE

E ardhmja e arsimit të lartë në Shqipëri: Bashkëkrijimi i politikave dhe praktikave të qendrueshme¹

2-3 Qershor 2023

Kongresi Rinor Kombëtar,

*Bulevardi Zogu i Parë, Rr. Papa Kristo Negovani, Pall.Li-Em, Shkalla 1, Kati 2,
Salla Actival*

Kontekst

Forum Rinor i Debatuesve: “E ardhmja e arsimit të lartë në Shqipëri: Bashkëkrijimi i politikave dhe praktikave të qendrueshme” është një forum 2 ditor diskutimi i realizuar nga Qendra “Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim” (SCiDEV) në kuadër të Javës së Shoqërisë Civile 2023, me mbështetjen financiare të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri si edhe të Fushatës “Nga Fjala tek Veprimi”, të mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë. Ky event organizohet si vazhdimësi e përpjekjeve të SCiDEV në fuqizimin e kapaciteteve të të rinjve përmes përfshirjes së tyre në programe që nxisin advokimin e bazuar në të dhëna, si “Fushata Nga Fjala Tek Veprimi” dhe Programi Rajonal Lëvizshmërisë për Liderhipin Rinor duke iu ofruar mentorim, mbështetje financiare, ndërlikdhje me vendimmarësit si edhe duke promovuar rezultatet e tyre.

Përgjatë Forumit, 30 të rinj, pjesëmarrës të edicionit të tretë të Fushatës “Nga Fjala Tek Veprimi”, alumni të Laboratorit të Debatit Universitar si dhe aktivistë nga grupime studentore e përfaqësues të studentëve në Këshilla Studentorë do të punojnë në grup për të draftuar propozime për zgjidhje në sfidat:

1. Lidhja e arsimit të lartë me tregun e punës
2. Pjesëmarrja e studentëve në vendimmarjen e institucioneve të arsimit të lartë
3. Digjitalizimi i arsimit
4. Qarkullimi i “mendjes”, diaspora dhe rinia

Propozimet e draftuara nga të rinjtë do t’u prezantohen politikbërësve, përfaqësuesëve akademikë dhe aktorëve të interesuar nga shoqëria civile, të cilët do të kenë mundësinë ndër të tjera të diskutojnë së bashku me të rinjtë aplikueshmërinë e propozimeve të tyre në sektorin respektiv si dhe të ndajnë me pjesëmarrësit përpjekjet e institucioneve të tyre në fushat të cilat do të shqyrtohen nga të rinjtë.

Ju ftojme ti bashkoheni Forumit Rinor të Debatuesve më 2 dhe 3 qershor, për të mësuar më shumë mbi perspektivën e të rinjve dhe aktorëve të tjerë institucionalë, si dhe nga biznesi e shoqëria civile në drejtim të adresimit të sfidave kryesore të të rinjve dhe arsimit të lartë në vend.

¹ Ky aktivitet u mundësua përmes mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian, si pjesë e projektit “Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile”, zbatuar nga Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA).

Agjenda

| Dita I 2 Qershor | SFIDAT DHE PERSPEKTIVAT NË FUSHËN E ARSIMIT TË LARTË SIPAS PERSPEKTIVAVE RINORE |
|---------------------|--|
| | Regjistrimi i pjesëmarrësve Kafe/Ujë |
| 10:00-10:05 | Fjalë përshëndetëse Orkidea Xhaferaj, SCiDEV |
| 10:05-10:15 | Prezantim i objektivave të Forumit dhe metodologjia e punës Jesmina Sengla, Koordinatore Projekti, SCiDEV |
| 10:15-11:00 | <p>Prezantim me drejtimet e Fushatës “Nga Fjala Tek Veprimi”</p> <p><i>Lidhja e Arsimit të lartë me tregun e Punës</i> Andi Kasa</p> <p><i>Pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrjen e IAL</i> Eneja Allmuça</p> <p><i>Digjitalizimi i Arsimit</i> Kejsi Elezi</p> <p><i>Qarkullimi i “mendjes, diaspora dhe rinia,</i> Danijela Ahmetaj</p> |
| 11:00-11:30 | Pyetje & Përgjigje |
| 11:30-11:45 | Ndarja në grupe Jesmina Sengla, Koordinatore Projekti, SCiDEV |
| 11:45-13:00 | <p>Punë në grup</p> <p>Lidhja e Arsimit të lartë me tregun e Punës Facilitues: Andi Kasa, Valmir Visha.</p> <p>Pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrjen e IAL-ve Facilitues: Melisa Peça, Eneja Allmuça</p> <p>Digjitalizimi i Arsimit, Facilitues: Ensild Hallanjaku, Tarkan Bashllari, Kejsi Elezi</p> <p>Qarkullimi i Trurit, rinia dhe diaspora, Facilitues: Ana Koliçi, Danijela Ahmetaj, Igli Domi</p> |
| 13:00-14:00 | Dreka |
| 14:00-15:30 | Vazhdim i punëve në grup |
| 15:30-16:00 | Prezantim i punëve & komente nga mentoret Abi Dodbiba, Lutjona Lula |



Ky projekt financohet nga
Bashkimi Evropian

Java e
Shoqërisë
Civile
2023

PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

QENDRA KOMBËTARE BURIMORE
PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI

SCiDEV
SCIENCE & INNOVATION FOR DEVELOPMENT

| Dita II 3 Qershor | | E ARDHMJA E ARSIMIT TË LARTË NË SHQIPËRI: BASHKËKRIJIMI I POLITIKAVE DHE PRAKTIKAVE TË QENDRUESHME | |
|----------------------|--|--|--|
| | | Regjistrimi i pjesëmarrësve Kafe/ujë | |
| 10:00 – 12:00 | | Vazhdim i punës në grup | |
| 12:00 – 13:00 | | Dreka | |
| 13:00 – 14:30 | | Finalizimi i prezantimeve të propozimeve | |
| 14:30– 15:00 | | <i>Ardhja e të ftuarve</i> | |
| 15:00 – 15:05 | | Fjalë hapëse dhe prezantimi i të ftuarve Blerjana Bino, Drejtoreshë Ekzekutive, SCiDEV | |
| 15:05 – 15:10 | | Fjalë përshëndetëse Arjola Agolli, Drejtoreshë e Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile, Partners Albania | |
| | | <i>Dialog për bashkëkrijimin e politikave dhe praktikave të qendrueshme</i> | |
| 15:15 – 16:00 | | Prezantimet ² <i>Lidhja e Arsimit të lartë me tregun e punës</i> Përfaqësuesi i Grupit <i>Pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrjen e IAL-ve</i> Përfaqësuesi i Grupit <i>Digjitalizimi i Arsimit</i> Përfaqësuesi i Grupit <i>Qarkullimi i Trurit, rinia dhe diaspora</i> Përfaqësuesi i Grupit | |
| 16:00-16:30 | | Ndarja e përshtypjeve dhe rekomandimeve për propozimet e të rinjve Dr. Ermelinda Durmishi, Drejtoreshë, Drejtoria e Arsimit të Lartë, Ministria e Arsimit dhe e Sportit Faola Hodaj, Drejtoreshë, Drejtoria e Inovacionit, Bashkia Tiranë Joniada Hito, përfaqësuese e Zyrës së Karrierës, Bashkia Tiranë. Prof. Asoc. Dr. Nevila Xhindi, Zv/Rektore, Drejtoria e Përgjithshme për Bashkëpunim Institucional dhe Zhvillim Projektesh, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë Albano Roçi, Specialist, Drejtoria e Diplomacisë Publike dhe Diasporës, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme Erjon Curraj, Ekspert i Transformimit Digjital, SCiDEV Enxhi Lipa, Kongresi Rinor Kombëtar | |
| 16:30 – 16:45 | | Diskutim | |
| 16:45-16:50 | | Përmbyllje dhe Fotografi | |

² Çdo grup ka në dispozicion 10 minuta. 7 minuta janë për prezantimin e propozimit, 3 minuta presin pyetje nga aktorët vendimmarrës.